



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1940/3 prot

Datë 04.09.2023

V E N D I M
Nr. 845/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.09.2023 me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar - Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj” me Nr. REF-76826-08-04-2023, me objekt “Blerje kancelari” me fond limit 1,637,550 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 17.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK me NIPT:
K21605003M
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, rruga Dytësore Km. 9,
Godinë 3 katëshe, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë
Adresa: Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020

“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.08.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar - Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj” me Nr. REF-76826-08-04-2023, me objekt “Blerje kancelari” me fond limit 1,637,550 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 17.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.

II.2. Në datën 08.08.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3348 dhe me nr. 1940 prot., datë 08.08.2023 e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të

plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesat e plota të ankimuesve.

II.4. Me shkresën nr. 3094/4 prot., datë 11.08.2023, protokolluar me tonën me nr. 1940/2 prot., datë 14.08.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues “Interlogistic” SHPK.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr. 3094/4 prot., datë 11.08.2023, protokolluar me tonën me nr. 1940/2 prot., datë 14.08.2023 rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK ku ka vendosur refuzimin e saj.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e shoqërisë “Interlogistic” SHPK në lidhje me kriteret e veçanta për kualifikim 2.3.2. dhe 2.3.3. se: *“Në lidhje me kriteret e mësipërme gjykojme që kërkesat e mësipërme janë shumë të ekzagjeruara, kufizuese dhe jo në proporcion me objektin e kontrates. Për të realizuar këto kërkesa, OE pjesëmarrës, duhet të bashkëpunojnë vetëm me prodhuesit apo me distributorët e autorizuar. Nderkohë, referuar artikujve të publikuar, objekt prokurimi kemi të bëjmë me artikuj të imet e të thjeshtë kancelarie, të cilat mund të sigurohen lehtësisht nga furnitorët të pafund, të cilët nuk operojnë mbi baza distribucioni si dhe nuk kanë katalogje të publikuara. Kërkesa për katalogje apo skedë teknike, nga prodhuesi apo distributor i autorizuar, ka kuptim dhe është përdorur nga shumë AK, për artikullin letër fotokopje/printimi, pasi specifikimet teknike të kërkuara për këtë produkt, nuk verifikohen dot me sy të lirë nga AK. Ndërsa për produktet e thjeshta të kancelarise, AK kanë të gjithë instrumentat, që të verifikojnë përputhjen e produkteve të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara. Ju sjellim në vëmendje Rekomandimin mbi hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit punëra, mallra, shërbime nga APP të datës 24.12.2021, ku APP përcakton në pikën 16 se “për procedurat e hapura të thjeshtuara, si procedura në fjale, AK duhet të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit. Së fundmi, sjellim në vëmendje të autoriteteve/enteve kontraktore se në rastin e procedurave të hapura të thjeshtuara, të përcaktojnë kriteret sa më të thjeshta pranimit, për operatorët ekonomike, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, duke mbajtur në vëmendje përcaktimet e nenit 55, pika 4, të RRPP, ku parashikohet: Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kriteret e sipërcituara, jo vetëm që nuk nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e lirë, por perkundrazi, kufizojnë pjesëmarrjen, pasi lejojnë të marrin pjesë vetëm OE që furnizohen nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar. Këto kërkesa nuk lidhen me garantimin e cilësisë. Për këtë arsye, kërkojmë modifikimin e këtij kriteri.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, 2.3.2 e 2.3.3. autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Shënim: Për produktet me nr.51 deri nr.61 sipas tabelës në Shtojcën 6), Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike”, për mallrat objekt prokurimi, sipas tabelës të paraqitur nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 6. Oferta teknike duhet të plotësohet me saktësi nga ofertuesi për të gjithë artikujt e listës. Në plotësim të kësaj kërkesë dokumenti “Ofertë Teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- Emërtimi dhe renditja e produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të

Nr.	Emërtimi i produkteve	Emërtimi kompanisë prodhuese.	Emërtimi i katalogut ose skedës teknike	Referenca në katalogje	Shënime (nëse gjykohet e nevojshme për sqarime nga ofertuesi)
				KOD i produktit ose nr. Faqes në katalog	

paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 6.

- Emërtimi i Katalogut ose skedës teknike të prodhuesit/distributorit të autorizuar. Referenca në katalogje, kodi produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr. i faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ose skedën teknike përkatëse për çdo produkt ku autoriteti kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në DST.
- Në fushën “SHËNIM” operatori ekonomik ofertues mund të shkruajë sqarime të ndryshme në lidhje me produktet e ofruara.

Shënim: Për produktet me nr.51 deri nr.61 sipas tabelës në Shtojcën 6), Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. ”.

III.1.2. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.3. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.4. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.1.5. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për paraqitjen e katalogut/fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktet e renditura nga 1 (një) deri në 66 (gjashtëdhjet e gjashtë) sipas renditjes në tabelën e Shtojcës Nr. 6, është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të katalogëve/fragmente të katalogut ose skedat teknike. Në këto kushte, KPP gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e katalogëve/fragmenteve të katalogut edhe pse është në përputhje me nenin 40, pika 6 gërma “b” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni gjykon, se referuar artikujve objekt-prokurimi, kemi të bëjmë me artikuj të thjeshtë kancelarie, për të cilët nuk është i nevojshëm një kriter i tillë. Për më tepër, kërkesa e AK-së në kriterin për kualifikim 2.3.2 tek (Kapaciteti teknik) të shtojcës 7 të DT, në të cilin kërkohen katalogët ose skeda teknike e prodhuesit, ndërkohë që ofertuesi mund të paraqesë edhe katalogët teknikë apo skedat teknike të produkteve të distributorit të autorizuar, vjen në kundërshtim jo vetëm me kriterin e përcaktuar nga vetë AK-ja në pikën 2.3.3 të shtojcës 7 të DT, por krijon konfuzion tek OE-të për mynyrën e përgatitjes së ofertës.

Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e dokumenteve të tenderit duke e hequr këtë kriter kualifikimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e thjeshtuar - Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*” me Nr. REF-76826-08-04-2023, me objekt “*Blerje kancelari*” me fond limit 1,637,550 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 17.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

